




**Republika e Kosovës**



**Kuvendi Komunal Gjiilan**

## **Njësia e Prokurimit**

**Gjiilan me datë: 25.11.2019**

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjiilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **21.11.2019**, të parashtruar nga GOperatori Ekonomik **I.P.N.EU** **SHPK & Infra-Plus SHPK & "Noti-Beton" SHPK** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Rregullimi i rrjetit të kanalizimit fekal në rrugën e Kumanovës deri te lumi në Livoçin e ultë"** me Nr. të Prok: 651-19-698-5-2-1 nxjerr:

### **V E N D I M**

Aprovohet Pjesërishtë kërkesa për ri-shqyrtim e Grupit të Operatorëve Ekonomik **Ekonomik I.P.N.EU** **SHPK & Infra-Plus SHPK & "Noti-Beton" SHPK** e dt. **21.11.2019** lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Rregullimi i rrjetit të kanalizimit fekal në rrugën e Kumanovës deri te lumi në Livoçin e ultë"** me Nr. të Prok: 651-19-698-5-2-1 kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës **20.11.2019** të publikuar ne platformën e prokurimit elektronik.

- 1. Vërtetohet Njoftimi mbi Vendimin e AK-së, të datës 20.11.2019.**
- 2. Autoriteti Kontraktues, do të bëjë përmisim lidhurë me validitetin e sigurimit të tenderit dhe vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.**
- 3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>**

### **A r s y e t i m**

Operatori Ekonomik **I.P.N.EU** **SHPK & Infra-Plus SHPK & "Noti-Beton" SHPK** me datë **21.11.2019**, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Rregullimi i rrjetit të kanalizimit fekal në rrugën e Kumanovës deri te lumi në Livoçin e ultë"** me Nr.

të Prok: 651-19-698-5-2-1, Autoriteti Kontraktues me datën 21.11.2019 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

**Autoriteti Kontraktues pas analizimit dhe shqyrtimit të pikave të cilat janë kontestuar nga ana juaj ka konstatuar se:**

Pretendimet e juaja ankimore lidhurë me vazhdimin e validitetit qëndronë:

**AK – Kuvendi Komunal Gjilan, gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve i ka trajtuar të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe ka vepruar në mënyrë transparente në harmoni me nenin Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi.**

**AK gjatë vlerësimit të ofertave ka hasure për OE Ekonomik I.P.N.EU” SHPK& Infra-Plus SHPK &”Noti-Beton” SHPK se keni vazhduar valeditetin e tenderit po ashtu edhe OE “ El-Bau” Shpk ka vazhduar valeditetin por per të dytë është bër gabim teknik andaj lidhure me këtë pretendim keni të drejtë ndërsa:**

**Autoriteti Kontraktues pas analizimit dhe shqyrtimit të pikave të cilat janë kontestuar nga ana juaj ka konstatuar se:**

**Grupi i Operatorëve Ekonomik .P.N.EU” SHPK& Infra-Plus SHPK &”Noti-Beton” SHPK, gjatë ofertimit nuk e keni përmbushure Kërkesa 4. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit : ku kërkohet Dëshmia 4- Dëshmi mbi pronësinë (apo te marrjes me qira ) te mjeteve ,Deklaratat unike doganore - Librezat e qarkullimit Lista e paisjeve duhet te jetë e notorizuar nga noteri me procedura en-minutes..**

**Ndërsa ju keni sjelle Vërtetim fakti mbi ofrimin e dokumentacionit Origjinal për të Vërtetuar Kopje identikë me Origjinalin dhe si i tillë shpalleni të pa përgjegjshëm, pasi që procedurën EN-MINUTE nuk e keni përmbushure sipas kërkesës 4, të FTD-së.**

Andaj komisioni për vlersimin e ofertave gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve duke u bazuar në **Ligjin mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe bazuar në rregullat e aprovuara nga KRPP të publikuara në webfaqen e KRPP-së -** ka konstatuar se Oferta e juaj është eliminuar për arsytet e lartë cekur.

**Dhe bazuar në të gjitha dëshmitë që posedon AK- Komuna e Gjilanit i hedh poshtë tpretendimet tjera ankimore.**

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv .

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-së duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;  
Arkivit të Komunës.

**Izet Kurteshi**  
  
U.D. Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit